

Tiranë, më 15 nëntor 2019

**Kërkesë**

“Për tërheqjen e kandidimit nga pozicioni i Inspektores së Lartë të Drejtësisë”

**Drejtuar: Gjyqtares Margarita Buhali**  
**Relatore në Këshillin për Emërime në Drejtësi**

E nderuar znj. Gjyqtare,

Unë, e nënshkruara Marsida Xhaferllari, me anë të kësaj kërkesë deklaroj me vullnetin tim të plotë dhe të lirë tërheqjen e kandidimit (heqjen dorë) tim, që kam depozituar për shqyrtim në Këshillin për Emërime në Drejtësi për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi interesi im i ligjshëm tashmë nuk ekziston më.

Siç duhet të jeni në dijeni, me dekretin nr. 11350, datë 13.11.2019 të Presidentit të Republikës<sup>1</sup>, jam emëruar në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, si dhe kam kryer procedurën e betimit përpara Presidentit të Republikës në datën 14.11.2019. Kjo detyrë e rëndësishme publike më detyron të fokusohem në përgjegjësi të reja, me një nivel të ri përkushtimi dhe serioziteti.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, ju uroj punë të mbarë,

Marsida Xhaferllari

<sup>1</sup> Shih <http://president.al/presidenti-meta-dekretin-emerimin-e-znj-marsida-xhaferllari-gjyqtare-te-gjykates-kushtetuese/>